REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT- VENDIM

Nr.130 Datë31.10.2025

"PËR MIRATIMIN E SHEMBJES SË GODINËS E CILA SHËRBEN PËR KOPSHTIN NR.4 SARANDË , PJESË E GODINËS SË SHTËPISË SË FËMIJËS " VANGJEL PULLA, PASURI NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË , PËR QËLLIM NDËRTIMIN E GODINËS SË RE TË KOPSHTIT"

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nënpika 1.1, shkronja "a" "c", nenin 23, pika 11, nenin 54, nenin 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.46 datë 16.01.2008 " Për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë , të pronës e cila është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëtor, dhe disa ndryshime të Vendimin nr.60 datë 1.02.2006 të Këshillit të Ministrave për listës së inventarit të pronave shtëtërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shërbimit social shtetëtor" me anë të cilës është transferuar në pronësi të Bashkisë Sarandë godina e "Qendra e Shërbimeve për femijër 6-14 vjeç", Aktekspertize dhe studimi i thelluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian :

VENDOSI:

1. Miratimin e shembjes së godinës e cila shërben aktualisht për kopshtin nr.4 Sarandë me sipërfaqe baze 489.1 *(katërqind e tetëdhjetë e nëntë pikë një)* m^2 , pjesë e godinës së Shtëpisë së fëmijës " *Vangjel Pulla"* , ndodhur në pasurinë nr.17/322/1 Zona Kadastrale 8641 pasuri në pronësi të Bashkisë Sarandë, për qëllim ndërtimin e godinës së re të kopshit ,bazuar në Akt-ekspertizën dhe studimin e thelluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës , bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesa e godinës e cila do të shëmbet individualizohet në planvendosjen bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Bashkia Sarandë të marrë të gjithë masat e nevojshme për nisjen dhe ndjekjen e procedurës së ndërtimit të godinës së re bashkëkohore dhe me standarde për kopshtit nr.4 Sarandë.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike , dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV.KRYETAR
Florjan SALI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË